

**JONATHAN
BOWDEN**



**GABRIELE
D'ANNUNZIO**



BOTIMET BRERORE

JONATHAN BOWDEN

**GABRIELE
D'ANNUNZIO**

Përktheu: Juxhin Halo

Redaktoi: Faust

© Botimet Brerore

brerore@outlook.com

2021

Në vend të një parathënieje

Eremiti i Gardones

Ditën e parë të marsit, një orë para mesit të natës, “Hornophoni” im, një radio austriake, markë e mirë, më solli një zë të mallëngjyer nga Roma: Arturo Marpicati, Kancelier i Akademisë Italiane, po përkujtonte kryetarin e tij, Gabriele D’Annunzio, që kishte vdekur tre orë më parë.

Kjo ngjarje e hidhur më ngjalli një kujtim udhëtimi. Vitin e shkuar, në një nga muajt e vjeshtës, nisesha me tren nga Venediku për një qytet të Lombardisë. Në stacionet e shumta që bënte, treni qëndroi ndonjë çerek ore dhe në Desenzano, një vend i vogël në mes të Veronës dhe Breshias.

Udhëtari që ndodhet në Desenzano, po të bëjë disa kilometra udhë me automobil, arrin në gjysmë ore në Gardone Riviera, ku ndodhet vila e D’Annunzios, që e quajnë “Vittoriale”. Po treni nuk pret dhe udhëtari kënaqet me një album, që mund ta blejë në një agjenci të vogël të stacionit me pak lireta.

Një album të Komandantit?

Ta japin, paguan, zë vendin në tren dhe ke kohë ta shfletosh me rehat, duke udhëtuar për në Breshia. Ndërkaq përpiqesh ta bësh sehir me mendje vilën e Poetit-Ushtar-Murg të Gardones, veshur me rrobën e kallogjerit, si Listi në vitet e tij të fundit, dhe futur në botën e misticizmit, që rronte gjithnjë fshehur te shkrimtari i “Piaçeres”.

Fluturimi lirik, që i jepte flakë tërë jetës së tij, e solli në një lartësim shpirtëror të madh. Dhe duke shkelur hirin e gërmadhëve të botës së humbur, nisi të vështrojë me ekstazë shkëlqimet e dritës së përgjeshme.

Dielli që perëndon i jep albumit të Komandantit që ke në dorë një ngjyrë të veçantë përmes dritareve të trenit. Ja shtëpia e Peskaras ku lindi D’Annunzio shtatëdhjetë e pesë vjet më parë

më 12 mars 1863. Një shtëpi popullore e përlulët, e cila sot është bërë faltore kujtimesh, sidomos që kur vdiq atje mëma e poetit, Luiza de Benediktis, së cilës D'Annunzio i fali, që kur ishte djalë, vjershat e tij më të thjeshta.

Që atëhere e gjer tek Eremiti i Gardones, sa etapa e sa episode të një jete të ndryshme plot ngjarje dhe anekdota, një jetë me të vërtetë e rrallë dhe e paimitueshme. Në mes të këtyre fytyrave të djalërisë e të pleqërisë, të agimit të parë plot shpresa dhe të perëndimit të lavdishëm, ka një vend të gjerë për të vënë D'Annunzion e viteve të para të Romës; romancierin e "Piaçeres"; poetin e "Laudi"; zotërinë e Kaponçinas e të Boka d'Arnos në mes të qenve, kuajve, kopshteve, pyjeve dhe buzëdetëve; të mërguarin e Acachon-it francez; D'Annunzion e luftës: që nga ai, që e rrethojnë pleq të thinjur me cilindër, gjer te aviator, marinar dhe arditi.

Tërë jeta e këtij njeriu, që i ka bërë të gjithë të flasin për të në tërë botën, po shpërdridhet në sytë e mi në këtë album që shitet në stacionin e Desenzanos për qëllime turistike. Tërë jeta e tij dhe pra tërë arti i tij. Sepse në fare pak shkrimtarë, arti është një me jetën, si te ky Poet, i cili mburrej pikërisht se i dha jetës kallëpin e artit të tij.

Çdo gjë ka qenë e bukur në jetën e D'Annunzios: thua se zhvillimi i një natyre të lumtur. E bukur ka qenë djalëria e parë, më tepër instinkt dhe hov sesa mendim, plot lëngje jetike; e bukur djalëria e dytë, dhënë pas një pune të paprerë, buzëqeshur nga të gjitha të mirat e jetës dhe të lavdisë, e bukur burrëria, në të cilën u realizuan shpresat e djalërisë; ca më e bukur pleqëria, e cila ka qenë një djalëri e pavenitur, mbajtur lart nga vullneti në vend të gjakut djaloshtar që mungonte; të bukura vitet e fundit të jetës së tij, vetmi e qetë në të cilën bënte sehir frytet e veprës së tij, fryte të gjallë në ngjarjet e kombit.

Njeri i kohës së tij dhe prekursor e lajmëtar i kohëve të reja. Ideal i pakufizuar, vullnet i pakufizuar, përsosje e pakufizuar – kanë qenë shpirti i jetës së tij dhe i veprës së tij.

Jeta e D'Annunzios ka në historinë shoqërore të Italisë po atë rëndësi që ka edhe në historinë letrare e poetike. Përmbloodhi në vetën e tij pasione, virtyte, fantazi, ëndrra, heroizma të popullit Italian që nga 1880-a e tëhu, dhe i vendosi në atmosfera mitike, duke u bërë për disa breza me radhë mësues qëndrimesh dhe modish shpirtërore mundane, estetike, civile, shtytës për guxime në luftë, ringjallës energjish të fshehura, të panjohura ose të largme.

Benedeto Kroçe, maja e kulturës së sotme italiane, një nga kritikët më të mëdhenj të kohës së sotme në tërë botën, kritikë më i rëndësishëm i veprës së D'Annunzios, e zë ngoje shumë herë në Historinë e Italisë të tij, e cila përfaqon një periudhë italiane pothuaj pesëdhjetëvjeçare, nga 1871 gjer më 1915. “Në rrethin e përgatitur nga D'Annunzio – kujton filozofi historian – u zhvillua në Itali filozofia e reagimit kundër pozitizmit”.

Më tej Kroçe vëren se D'Annunzio ka qenë babai shpirtëror i imperializmit dhe nacionalizmit Italian, gjë të cilën e ka vërtetuar edhe doktrinari i nacionalizmit Italian Koradini në revistën “Regno” të Firences në 1903-shin. Në këtë nacionalizëm D'Annunzian, i cili, sipak Kroçes ka qenë sadik e diletantesk, shkrimtarët italianë të nacionalizmit futën element intelektualë, të marrë më parë nga nacionalizmi sadik francez i Barres-it, nga nacionalizmi racionalist i Morrosë dhe i “Action Française”, si dhe nga sindikalizmi dhe teoria e violencës e Sorelit.

Treni po hyn në stacionin e Breshias, një nga stacionet më të bukura që ka kudo Italia, bile më të bukura nga disa stacione që kam parë në Austri e në Francë, dhe Album i Komandantit ndodhet hapur në faqen e fundit.

Udhëtari kthehet prapë me mendje në Gardone, karshi gadishullit Sirmione, në tokën që ka kënduar Katuli, Dante, Karduçi, Tenison, ku ndodhet vila në të cilën D'Annunzio vuri vulën e artit dhe të shpirtit të tij.

Në manastirin e Gardones, që lulëzon tërë vitin benda në ujra, Poeti-Murg mund të dëshironte gjithnjë anën e përtejme të liqenit dhe të realizonte vjershën e tij nostalgjike:

*La gioia e sempre
Sull'altra riva!*

“Hornophoni” im më solli në mesin e natës së ditës së parë të marsit lajmin se Komandanti u hodh matanë për të shijuar edhe atje gëzimin e jetës. Nga ana e lavdisë tokësore në anën e lavdisë qiellore.

Vangjel Koça
1938

Gabriele D'Annunzio

Në thelb, Gabriele D'Annunzio pati dy karriera, një prej të cilave ishte ajo e shkrimtarit dhe intelektualit, kurse tjetra ajo e politikanit dhe e figurës kombëtare. Nëse i hidhni një sy faqes së tij në Wikipedia, do të zbuloni një ngjarje të çuditshme që ndodhi në vitin 1922. D'Annunzio u shty jashtë dritares së një ndërtese, u plagos keqazi, e pothuajse u sakatua për një farë kohe. Sigurisht, kjo ngjau gjatë një periudhe kyçe të politikës italiane,

Musolini u shndërrua në prijës të vendit, u bë kryeministër pas Marshimit në Romë, në një sistem që ende ishte monarkik. Musolini përthithi e gëlltiti të gjitha partitë e tjera Italiane me qëllim krijimin e shtetit Fashist në Itali që zgjati deri në fund të luftës së dytë botërore.

D'Annunzio si figurë ishte i përfshirë në lëvizjen *romantike* dhe *dekadentiste* të letërsisë italiane. Ai shkroi një numër të madh dramash, një numër mjaft të madh operash, shumë romane, dhe disa koleksione tregimesh. Statusi i tij si figurë e diskutueshme, ishte arsyeja pse nuk u shpërblye ndonjëherë me çmimin Nobel apo diçka të ngjashme. Ishte një nga njerëzit më të famshëm të Italisë së fillimshekullit të XX-të. Pothuajse të gjithë kishin njëfarë mendimi mbi të, pothuajse të gjithë e njihnin.

Vepra e tij ndërthur forca të ndryshme pagane, vitaliste dhe niçeane. Ai ndikohej së tepërmi nga filozofia e Friedrich Nietzsche. Disa nga veprat e tij u ndaluan për të ruajtur moralin publik. Iu ndalua si botimi i tyre, ashtu edhe përkthimi në gjuhë të huaja.

Flaka e Jetës ishte një nga lëvdimet e tij më të dalldisura dhe bajronike të jetës. *Triumfi i Vdekjes* ishte një tjetër vepër, po ashtu *Vashat e Shkëmbinjve*, si dhe një poezi e quajtur *Halkyon* e cila bënte pjesë në një varg të ndërlidhur prej pesë poezish. Ai donte të shkruante një koleksion më të madh, mirëpo arriti të përfundojë vetëm të lartpërmendurat.

Gjithashtu, ai lëvdon periudhën e Renesancës, dhe periudhën e madhështisë italiane kur qytetërimi italian ishte sinonim i qytetërimit Perëndimor dhe përnjëmend dukej se do të linte gjurmë të theksuara mbi qytetërimin botëror.

Pra, D'Annunzio bashkoi një numër të madh rrymash që rridhnin në politikën dhe kulturën Italiane që prej bashkimit të Italisë së Garibaldit në shekullin e XIX-të. Ashtu si Gjermania, Italia u bë shtet-komb modern dhe europian, paksa vonë, e për pasojë një ndjenjë ngadhënjimtare e pararozjizmit kombëtar, identitetit, trysnisë e fuqisë, ishin gjithmonë pjesë e ideologjisë së D'Annunzio-s.

Nëse do hidhnim një vështrim të përciptë mbi çështjen, ekzistenca e artistëve që pajtonin individualizmin e skajshëm me kombëtarizmin e flaktë, si Maurice Barres në Francën e viteve 1890- (autor i librit *Kulti i Vetes "Le Culte du Moi"*, vepër e shkruar në vija niçeane dhe stirneriane e që shpallte një individualitet të tejskajshëm), do na dukej e çuditshme.

Kjo ndodh sepse ky kult i individit heroik, i mashkullorizmit, ky kult i mbinjeriut dhe i individit pagan (që pasqyroheshin të paktën deri diku në novelat angleze të D.H.Lawrence) shkonin dorë për dorë me besimin në ripërtëritjen dhe lavdinë kombëtare.

Individi madhështor konsiderohej si model i burrit të madh të kombit, dhe si një prijës kombëtar së paku në trajtë embrionale, pavarësisht nëse vepra merrte ngjyrimë politike ose jo. Pra, doktrina kolektiviste e kombit, dhe ajo individualiste e njeriut të madh, shkrihen, bashkohen dhe përputhen në mënyra të ndryshme krijuese. Ky fenomen ishte pjesë e tensionit krijues të fundshekullit të XIX-të.

D'Annunzio është figurë e shekullit të XIX-të që shpërthimin e gjen në shekullin e XX-të si pasojë e politikës së mekanizuar. Borxhet dhe përndjekja nga njerëz të ndryshëm për shkak të stilit të jetesës jashtëzakonisht luksoz dhe aristokratik, e detyruan D'Annunzion të zhvendosej në Francë në kohën e

shpërthimit të luftës së parë botërore. Sidoqoftë ai u kthye nxitimthi në Itali, duke kërkuar të rreshtohet në luftë krahas aleatëve ose krahas perëndimoreve ose krahas aleancës trepalëshe. Sigurisht që në Luftën e Parë Botërore Italia luftoi krahas aleatëve perëndimorë, krahas Francës, Rusisë dhe Britanisë, kundër Gjermanisë, Perandorisë Austro-Hungareze dhe Perandorisë Osmane, në përleshjen e vrullshme që i bëri njerëzit që jetuan gjatë asaj periudhe, të mendonin se kjo luftë do t'i jepte fund gjithë luftrave.

D'Annunzio pati një përvojë të jashtëzakonshme gjatë luftës. Iu bashkua luftës rreth të pesëdhjetave, duke zënë vend tek pozicioni më aristokratik prej të treve që ekzistonin asokohe. Është e dukshme se lufta nëpër qiej, tërhiqte njerëz me prirje të hareshme, individualiste dhe aristokratike.

Figura të larmishme si Goering, i forcave ajrore Gjermane, Mosley i forcave Britanike, dhe D'Annunzio i forcave italiane - që të tre u përplasën në një luftë që gjatë rrugëtimit të saj s'kishte dhe aq shumë lidhje me ushtritë jashtëzakonisht të motorizuara që po luftonin në terren.

Ekzistonte një dallim i çuditshëm mes ushtrive të mëdha në terren, fortifikimeve prej çeliku me tunele që e bënin sipërfaqen e tokës të ngjashme me sipërfaqen e hënës, situatë që zgjati derisa u zhvilluan tanqet që mund të çanin përmes natyrës shterpë të luftës gërryese në front.

Një trajtë tepër e ngurtë e luftimit që zgjati nga 1915 deri nga përfundimi i luftës në 1918. Prapësëprapë nëse vështroje lart në qiell, mund të qëmtoje lirinë, këtë liri të qiejve, një gumëzhimë fluturakësh të montuar me beze, dru dhe tel, jashtëzakonisht të brishtë nëse do i krahasonim me modelet e sotme, shumicën e kohës të papajisur me parashuta, ku burrat shpesh shkrepnin pushkë dhe pistoleta ndaj njëri-tjetrit, deri kur u vunë në përdorim mitralozët e parë, gjë që mundësoi përplasjen e njëmendtë në fluturim e sipër.

Ekzistonte një kult kalorësiakësh nëpër qiej, që në të vërtetë nuk është se mbikqyrte fuqitë e mëdha të rreshtuara kundër njëra-tjetrës atje poshtë, në tokë.

Ky kult i jepte luftës së qiejve një përmasë shpirtërore që vërehej shumë nga burrat që luftonin atje lart. Kjo përmasë pasqyronte “të jetuarin hareshëm” dhe besimin tek rreziku dhe forca, që përbashkonte D’Annunzion me lëvizjen futuriste të Marinetti-t dhe me shumë rryma anti-borgjeze të jetës kulturore dhe estetike të kohës.

Me mbylljen e shekullit të XIX-të, në Europë u shfaq një grup i madh mendimtarësh dhe shkrimtarësh si Maurik Bare në Francë, D’Annunzio dhe Marinetti në Itali, që tmerroheshin nga shterpësia e jetës së fundshekullit, dhe që ishin të etur për përleshjet që do të përfshinin Europën dhe botën në shekullin pasardhës. Ekzistonte një gjendje ku çdo epokë (sikundër e jona) i paraprinte ngjarjeve në vijim, përmes gjithfarë ideologjish heterogjene e kundërshtuese.

Këto ideologji qartësohen vetëm pasi të kesh jetuar gjatë periudhës pasuese. Midis viteve 1880 dhe 1910 pati një tharim të pafund të mendimit që lëvrohej në shoqëritë e kafeneve të Europës, me burra vullnetplotë si Stalini dhe Hitleri.

Burra që planifikonin të ardhmen, ose rolin e tyre në një të ardhme të largët. Burra të etiketuar shpesh si sharlatanë dhe ëndërrimtarë, utopistë endacakë që ndodheshin në skaje të ngjarjeve, por që më vonë patën fatin e të kapërcyerit drejt e në qendër të kulturës dhe pritshmërive Europiane.

Shkrimtari Jean Cocteau rrëfen një histori të bukur mbi Leninin. E kishte takuar gjatë një feste në një shtëpi në Francën e vitit 1910. Si të thuash, ai po kujdesej për shtëpinë gjatë kohës kur pronarët ndodheshin diku tjetër.

Kokto u tha miqve: “Po ti kush je?” dhe burri iu pergjigj, deri diku me mburrje, “Njerëzia më quan Vladimir Ilich Ulyanov. Njihem si Lenin. Po thur shkatërrimin e regjimit Carist Rus dhe synoj ta zhduk gjithë klasën sunduese të Rusisë dhe të vendos

një diktaturë të proletariatit.” E tha kështu troç e me një frymë! Të gjithë i thanë: “Epo goxha interesante qenka! Të lumtë zotëri!” E pyeti sërish: “Po tani me se po merresh?” E Lenini iu përgjigj: “Redaktoj një revistë të vogël të quajtur *Iskra*, *Shkëndija*, që është fillimi i tharmimit të energjive revolucionare që po shfaqen në Rusi dhe si përfundim në botë!” E ata menduan, “Epo kjo qenka interesante!”

Sa të abonuar kishte *Iskra* asokohe? 400? 40? 4?

Kështu, Vladimir Ilich Ulyanov do të shfaqej në rrëmujën e Ruisë post-revolucionare, teksa Rusia vuante për shkak të humbjes ndaj Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore, do të bëhej prijësi i shtetit të parë revolucionar e më helmues në botë. Asgjë nuk mund të parashikohet në këtë jetë.

Kur komanda e lartë Gjermane mbylli brenda në një tren drejtuesit Bolshevikë, përfshirë këtu Vladimir Ilich-in, dhe e dërgoi përmes territoreve të pushtuara e drejt Ruisë së Madhe me shpresën se këta do të krijonin më tepër rrëmujë dhe më shumë shqetësime, sigurisht që s’menduan se ky grup i vogël do të shtinte në dorë 11-12% të votave parlamentare dhe më vonë do të merrte frerët e një shteti të dobësuar me anë të një force të vogël parashtarake. Sepse Revolucioni Bolshevik nuk ishte aspak një revolucion mbarëshoqëror ashtu siç pretendonin predikuesit e tij për më tepër se gjysmë shekulli që pasoi. Ishte një grusht shteti i armatosur, i orkestruar nga krahu i armatosur i një partie politike të vockël.

Ekziston një rrëfenjë e famshme mbi Leninin, Trotskin dhe Stalinin që flinin të gjithë në një dhomë të shtruar me gazeta një ditë pas revolucionit. Lenini tha: “Shokë! Ka ndodhur diçka shumë e rëndësishme! Janë bërë plot njëzet e katër orë qëkur morëm pushtetin!”. Territori rus që kontrollonin sigurisht që ishte i papërfillshëm.

Pra, duhet kuptuar se ky tharmim idesh, djathtas, majtas, qendrazi, fetare, estetike e kështu me radhë, ndodhi ndërmjet 1880-ës dhe fillimit të periudhës që do të paraprinte luftën e parë

botërore, periudhë nga e cila dolën në pah shumica e ideologjive moderne të gjysmës së treçekut të parë të shekullit të XX-të.

Në masë të madhe, ishte D'Annunzio ai që krijoi Fashizmin Italian. Pothuajse gjithçka që më vonë u artikulia nga lëvizja e drejtuar nga Musolini e pati zanafillën tek idetë e tij.

Ideja e Njëshit, mbi popullin, e njëherazi pjesë e tij, ideja e një grupi *Guximtarësh*, njerëz të zjarrtë dhe fanatikë të ndërkryer, që përshëndesin sipas mënyrës krahëzgjatur Romake, që vishen me të zeza dhe që shërbejnë si audiencë për prijësin, e në të njëjtën kohë janë mbrojtësit e tij, disiplinues të posaçëm që sigurojnë dakordësinë e masave ndaj ligjërimeve të prijësit. Ata janë gjithashtu njëfarë kori kombëtarist... Të gjitha këto ide vijnë nga D'Annunzio, nga periudha kur ai pushtoi dhe italianizoi portin e Fiumes.

Pra, deri në një farë mase, përpjekja për ta hequr qafe D'Annunzion në 1922, përpjekje që e nxorri atë jashtë loje për një periudhë kohe, vërtetonte rolin kyç që ai kishte në politikën italiane. Ai ishte i vetmi rival i Musolinit, për drejtimin e asaj çka do të njihej më vonë si e djathta e skajshme. Fashistë të caktuar me rastë i kthenin sytë nga D'Annunzio kur fati i lëvizjes së tyre merrte të tatëpjetën.

Bie në sy se gjatë zaptimit të Fiumes, D'Annunzio mendonte se duhej të ndodhte një marshim në Romë, për pasojë ai nxitoi të rreshtohet krah Fashistëve dhe forcave të tjera të ripërtëritjes dhe vrullit kombëtarist të jetës italiane, pas fitores së Italisë në luftën e parë botërore.

Ai marshim nuk u bë kurrë, por sigurisht që do të ndodhte më vonë kur Musolini dhe udhëheqës të tjerë arritën të bënin një marrëveshje me establishmentin Italian të kohës. Marshimi Musolinian drejt pushtetit, ishte njëfarë grushti shteti me pëlqimin e vetë shtetit që po vihej nën kontroll. Nuk ishte grusht shteti që i kundërvihej natyrës së shtetit.

Kështu, në njëfarë mënyre, marshimi Italian ishte kapërcimi i një pragu - dera e të cilit ishte tashmë e hapur, dhe vetëm forca

si komunizmi Italian e kështu me radhë, të cilat ndodheshin jashtë kufijve të shtetit dhe kompetencave të tij mbi burimet politike, i kundërviheshin veprave të Musolinianëve.

Ekziston një këndvështrim sipas të cilit Mussolini dhe lëvizja Fashiste, e normalizuan dhe e menjanuan pakëz romancën nga ideja heroike që mbrohej nga D'Annunzio. D'Annunzio ishte artist, dhe kur Fiume, që është pjesë e Kroacisë, u mor nën kontroll nga 1000-3000 paraushtarakët e tij në fillimet e viteve 1920-të, (pasi shumica e banorëve ishin italianë, dhe ai dëshironte ta shtinte në dorë për lavdinë e Italisë në kontekstin e shpërndarjeve territoriale të pasluftës), ai menjëherë e bëri muzikën gurthemel të qytet-shtetit të Fiumes. Deri diku kjo ishte pjesë e retorikës dhe estetizmit të skajshëm që D'Annunzio pëlqente.

S'ka ndonjë praktikitet politik në caktimin e muzikës si virtyt kryesor të shtetit, dhe në krijimin e asambleve shtetërore të idealizuara, të karakterizuara nga dërdëllitjet e pakta. D'Annunzio nuk besonte tek demokracia parlamentare por në një formë qytetarie ku çdo pjesëtar i kombit vetpërfaqësohej. Për këtë arsye në Fiume nisi të krijohet një shtet korporativ, u krijua një asamble e dakordësimit e përbërë nga fermerët, punëtorët, punëdhënësit, kleri, industrialistët e kështu me radhë.

Të gjitha këto në një formë që Mussolini do ta përvetësonte, sepse shumica e veprave Musoliniane qenë bërë paraprakisht përgjatë grushtit të shtetit moral dhe estetik të D'Annunzios.

D'Annunzio besonte se jeta duhet të jetë e shkurtër, e vrullshme dhe sa më heroike që të jetë e mundur. Italianët duhet të frymëzohen nga parimet e Perandorisë së lashtë Romake dhe të Renesancës. Me fjalë të tjera, ai rrëmoi brenda një harku kohor prej mijëra vitesh të kulturës italiane, për të gjetur majat më të larta mbi të cilat të ndërtonte Italinë e shekullit XX. Në varrimin e tij të vitit 1938, Mussolini shpalli se Italia përnjëmend do t'i synonte ato maja që D'Annunzio dëshironte. Ai gjithmonë

kishte dashur një Itali fitimtare, lojtare kryesore në ngjarjet Europiane dhe ndërkombëtare.

E vërteta është që Italia për pjesën më të madhe të ekzistencës së saj gjatë shekullit të XX-të nuk ishte një lojtare e parëndësishme, por as nuk radhitej midis lojtarëve madhorë. Pakashum, radhitej midis fuqive dytësore të Europës.

Deri në njëfarë mase, shumë aventura ushtarake italiane që patën për pikënisje Musolinin, mbështeteshin tek mbrojtja dhe ndihma e gjermanëve sapo sharra ngecte në gozhdë. Megjithatë, aventurat perandorake në Etiopi dhe gjetkë u mbështetën nga D'Annunzio, i cili u afrua shumë me regjimin kur kuptoi se ata dëshironin të ndërtonin një perandori neo-Italiane me me tipare romake.

D'Annunzio gjithashtu mbështeti daljen e Musolinit nga Lidhja e Kombeve. Besonte se italianët e shtypur që jetonin jashtë Italisë, duhet të përfshiheshin në shtetin amë përmes irredentizmit. Irredentizmi është ideja e përfshirjes së njerëzve të kombësisë tënde që ndodhen jashtë kufijve të shtetit kombëtar, përmes pushtimit të territoreve të ndërmjetme ose duke i bashkëngjitur këto territore në një federatë më të madhe.

Është ideja e pasjes së një kombi më të madh: Britania dhe Britania më e Madhe, Italia dhe Italia e Madhe, Rusia dhe Rusia e Madhe e kështu me radhë.

Deri në një farë mase, D'Annunzio u radhit krah forcave të modernizmit konceptual pa qenë vetë i tillë. Në aspektin letrar dhe gjuhësor ai ishte përnjëmend romantik sipas modës së shekullit të XIX-të, por ndjeshmëritë e tij ishin jashtëzakonisht moderne.

Në letërsinë bashkëkohore Italiane s'ka ndonjë konsensus të qartë e të thjeshtë mbi D'Annunzion. Normalisht do të mendohej se një burrë që vdiq në 1938-ën, karriera politike e të cilit mori fund më 1922, padyshim se do i përkiste të shkuarës për nga ndikimi. Mirëpo D'Annunzio ende gjëllin nëpër bisedat e përditshme në Itali, dhe ende zotëron një tis diskutueshmërie,

jo më pak për shkak të “seksizmit” Bajronik të romaneve, poezive, dramave, skenarit të një shfaqjeje, dhe libretove të operave.

Shto këtu faktin e të qenit pararendës i fuqishëm i Fashizmit Italian, shpesh i quajtur *Duçja i parë*, prijësi i parë, prijësi i parë fashist i famshëm që Italia pati përpara ardhjes në pushtet të Musolinit. Ky është pra reputacioni i tij tepër përçarës në letërsinë Italiane.

Centristë e të majtë në Itali reagojnë me një “Oooh jo!” sapo përmendet emri i D’Annunzios. Imagjinoni nëse mundni një D.H. Lawrence fashist që më vonë pati karrierën e Mosley-t deri në njëfarë mase. Ky është i vetmi shembull britanik që mund të jepet për një burrë si D’Annunzio. Lawrence, sigurisht, do të kish pasur një reputacion krejt të ndryshëm nëse do të miratonte politikat e Gjermanisë Naziste në të njëjtën mënyrë që pat miratuar lehtëshëm politikat e Italisë fashiste.

Në njëfarë mënyre, Lawrence, i cili deri diku u shndërrua në një figurë kult, falë kritikës letrare të Kembrixhit të F.R. Lewis në Britani dhe I.A. Richards në Shtetet e Bashkuara pas luftës së dytë notërore, nuk do të ishte ngjitur kurrë në ato maja nëse do të kish miratuar çështje të caktuara politike të viteve 1930-të dhe 1940-të. Kështu, deri diku, vdekja e tij e parakohshme ishte e dobishme përse i përket reputacionit të pasluftës.

Robinson Jeffers, poeti pagan Amerikan me të cilin Lawrence komunikonte gjatë jetës së tij goxha burrisht, u harrua pas luftës së dytë për shkak se mbronte izolacionizmin dhe jo sepse kishte simpati për Boshtin, si një Amerikan neutralist. Izolacionizmi është një mendim së tepërmi nacionalist për kontekstin Amerikan të gjërave.

Besimi se Amerika nuk duhet të përfshihet në luftrat e tepërta të shekullit të XX-të, ajo që Heri Elmer Barns e quan luftë të vazhdueshme për paqe të vazhdueshme. Amerika duhet të tërhiqet nga ndërhyrjet nëpër botë, duke mos u shqetësuar për

ngjarjet jashtë saj, e me raste të hedhë sytë drejt Karaibeve dhe Amerikës Latine. Por Lawrence do të kishte ndjekur të njëjtën udhë si Jeffers nëse do të kish pasur një karrierë si ajo e D'Annunzios, dhe nëse do të kish miratuar disa nga qëndrimet e tij.

Qëndrimi i D'Annunzios mbi Fashizmin “e huaj” ishte kontradiktor, sepse ai ishte një kombëtarist fund e krye. Në fund të ditës shqetësohej për fatin e Italisë, dhe jo për vendet e tjera. Mbështeti daljen nga Kombet e Bashkuara, por ngjashëm me Çarls Maurras në Francë ishte më tepër kombëtarist sesa fashist. Kombëtarizmi i tij ishte proto-fashist edhe pse në të njëjtën kohë solli shumë nga ato ngjyrime estetike që do të shquanin diktaturën politike në Itali.

D'Annunzio zotëronte një kurajo vetjake të madhe, në qenien e tij ndërthurej egërsia e luftëtarit me ndjeshmërinë e artistit. Njëra nga bëmat e tij famëlarta ishte një fluturim vajtjeardhje prej 700 miljesh me qëllim shpërndarjen e fletushkave pro-Perëndimore/pro-Italiane në Vienë, gjë që mbahet mend deri sot e kësaj dite.

Një bëmë tjetër ishte sulmi i anijeve Gjermane me anë të varkave të vogla të motorizuara. Sulm ky që i paraprin një pjesë të madhe të luftës moderne ku anije të mëdha e aeroplanmbajtëse gjigande mund të shkatërrohen nga varka të vogla që shpejtojnë rreth tyre.

Ky është parimi i luftës guerrilase asimetrike, entitete shumë më të mëdha mund të gozhdohen nga kundërshtarë liliputeskë. Sërish, kjo mënyrë luftimi prej forcash speciale, qoftë në qiell apo në det, ishte pjesë përbërëse e estetikës dhe etikës D'Annunziane.

Mënyra e luftimit modern është dukshëm e karakterizuar nga një nocion i kurajos vetjake që nuk fashitet kurrë. Megjithatë, lufta reduktohet aq fort në përplasje mes batalioneve të mëdha, aq shumë në shëkmbime të kulluara të zjarrit, në harxhim forcash mes njësisish masive të ndërsyera kundër njëra-tjetrës,

saqë përplasjet individuale e humbasin nga pak kuptimin. Sidoqoftë, kjo kuptimësi katapultohet në zona të tjera: tek snajperi, elita e varkëtarëve apo e guerriljeve. Luftëtari i përkryer i qiejve shndërrohet në homologun e luftëtarit vetmitar, besnik ndaj ideologjive luftarake të qytetërimeve të mëparshme. Kjo mund të qëmtohet në mënyrën sesi këta burra mendonin për veten dhe misionin e tyre.

Në një ligjëratë të mëparshme, fola për Yukio Mishimën dhe ideologjinë e samurait të ngritur mbi kultin e *bushido-s* në Japoni. Kjo është ideja e një elitizmi luftarak, pothuajse estetik ku përmasa artistike dhe fetare nuk mungojnë, së bashku me pasjen e një sistemi moral që justifikon vrasjen. Të treja ofrohen në një pako. Një burrë si D'Annunzio i mishëronte shumë nga këto vlera në një trajtë të kulluar Europerëndimore dhe Eurojugore.

Kontributi i D'Annunzios në luftë ishte aq i madh sa arriti të merrte shumicën e dekoratave, përfshirë këtu medaljen e artë, të barazvlefshëm me Kryqin e Fitores, së bashku me disa kryqe të tjerë të argjendtë dhe një kryq bronzi. Gjithashtu i'u akorduan medalje të tjera, një kryq i ushtrisë Britanike pasiqë kish luftuar në anën e Aleatëve dhe Britanikëve në luftën e parë botërore.

Musolini dhe nacionalistë të tjerë italianë kishin bindjen se Italia nuk arriti të marrë kompensimin që priste nga lufta eparë botërore. Kjo, në thelb, vlen për pothuaj të gjithë, por njëherazi duhet thënë se Italia u rreshtua krahas grupit të fuqive dytësore për nga rëndësia në krahasuar me Britaninë SHBA-në dhe Francën.

Roli i tyre në paqen e pasluftës, një paqe e dhimbshme dhe e dëmshme për Gjermaninë e mundur, do të kishte pasoja të rënda në dekadat e ardhshme. Kjo paqe s'kishte lidhje me dëshirat e Italisë. Njëra nga arsyet për pushtimin e asaj toke, që më vonë do bëhej pjesë e Jugosllavisë, (Fiume) nga trupa paraushtarake Italiane të drejtuara nga D'Annunzio ishte pakënaqësia e tij ndaj rolit që luajti Italia në tryezën e pasluftës.

D'Annunzio besonte tek “Një Itali” dhe “Itali Përjetë” dhe “aty ku një Italian vuan, Italia duhet të jetë aty për ta mbrojtur”.

Ishte ky besim që frymëzoi mijëra burra të ngriheshin dhe të shkonin pas flamurit të D'Annunzios. Në fazat e hershme të sulmit mbi Fiume, ai kishte rreth 300 burra pas vetes. Në fund, ky numër u dhjetëfishua.

Në internet mund të gjesh pamje nga mitingjet e vitit 1921 ku turma gjigande brenda qytetit, madje pothuajse i gjithë qyteti grumbullohet për të brohoritur D'Annunzion i cili mbante fjalime plot retorikë nga ballkoni. Këto janë përnjëmend skena Musoliniane ku figura e diktatorit, ose në rastin e D'Annunzios diktatorit që s'u bë kurrë diktator, iu drejtohet turmave që vështrojnë lart për nga ballkoni që ndriçohet nga drita skenike.

Të gjitha këto ishin pjesë përbërëse të teatrit D'Annunzian. D'Annunzio gjithmonë u bënte turmave pyetje retorike si: “A e doni Italinë?” Dhe përgjigjia ishte: “Poo!” E më pas vijonte një pyetje tjetër nga D'Annunzio, e pas kësaj një tjetër reagim nga turma. Këto ishin mbledhje turmash gjigande të cilat vështirë se mund të kontrolloheshin. Prandaj sa herë që ndokujt në turmë i shkrepse mendja për t'u shpallur kundra, ekipet e burrave të veshur me të zeza e të vendosur nëpër turmë nga D'Annunzio, i jepnin një mësim të mirë “keqbërësit”.

Kjo përzierje e mbështetjes me njëfarë presioni psikologjik, është e gjitha pjesë e festës kombëtariste që një burrë si D'Annunzio besonte se duhej ndërtuar pothuajse si një shfaqje teatrale ku turma kontrollohet duke u ngopur me përgjigje ndaj pyetjeve retorike, dhe në disa momente lejohet të ulërijë e të piskasë derisa rraskapitet, dhe më pas burri shkon tek cepi i ballkonit për të mbajtur sërish fjalim.

Të gjitha këto janë praktika që do të zhvilloheshin më tej nga Musolini. Kështu, D'Annunzio në një farë kuptimi krijon një model teatral që do të përvetësohej e zhvillohej më vonë nga kombëtarizmi radikal italian.

Nuk arriti të jetojë aq sa për të përjetuar zhvillimin e plotë të fashizmit, por qeveria Musoliniane u ndje e detyruar për ta marrë me të mirë. Pyetjes së ngritur nga një drejtues fashist mbi

trajtimin special të D'Annunzios nga regjimi, Musolini i përgjigjej me këto fjalë:

“Dhëmballa e kalbur trajtohet në dy mënyra. E shkul dhunshëm ose e mbush me ar dhe unë kam vendosur të ndjek rrugën e dytë.” Kështu, D'Annunzios iu dha një shumë e madhe parash nga shteti Italian për tu betuar se nuk do të përfshihej në politikë pas vitit 1922, diçka që e bën atentatin e supozuar ndaj tij të vitit 1922 një tentativë të mistershme.

S'dihet në ishte një tentativë për ta vlarë ose jo. Sidoqoftë kjo ngjarje e mbuluar me mister e nxorri nga loja D'Annunzion gjatë gjithë periudhës kur Musolinianët marshuan drejt pushtetit me plot kuptimin e fjalës.

Më vonë ai u shpërblye me drejtimin e të barazvlefshmes së Shoqërisë së Arteve; iu dha një bursë nga shteti e cila pagoi printimin dhe botimin e plotë të veprave të tij nga vetë shteti Italian. Vepra të cilat u shpërndanë në të gjitha libraritë, shkollat dhe universitetet. Mori medalje të shumta nderi; shtëpia e tij u shndërrua në një muze që ende ekziston dhe është një nga pikat kryesore turistike në Italinë e sotme. Aeroplanët që ai pilotoi dhe varkat që voziti janë restauruar.

Krahas tyre qendrojnë biblioteka, instituti i kërkimeve ushtarake dhe lloj-lloj fotografish nga periudha e atëhershme. Ekziston një mauzole i madh, dedikuar D'Annunzios, një monument i rëndësishëm i Italisë bashkëkohore. Atë e krahasojnë në disa drejtime me Garibaldin, figurën e shekullit të XIX-të që përmes lëvizjes Këmishëkuqe, ndihmoi në bashkimin e Italisë duke e shndërruar nga një komb i përçarë dhe grindavec, në një shtet kombëtar modern.

D'Annunzio është një nga ato figurat sintetike dhe sinkretike, në të cilën shkrihen disa jetë të ndryshme: dashnori, ushtari, estetisti, luftëtari politik, shkrimtari, artisti. Ai shkriu katër ose pesë jetë në një të veçantë, arriti të bashkojë grupe të ndryshme politike të Italisë së atëhershme.

Kur u zgjodh në senat si një konservator i pavarur, aty nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, D'Annunzio s'kishte ndonjë bindje politike përnjëmend sektariste me përjashtim të një besimi në konservatorizëm dhe revolucion, siç shprehej me fjalët e tij. Më vonë, ai kërceu tek krahu i kundërt i sallës parlamentare, u bashkua me të Majtën për të marrë pjesë në një votim që zhbllkoi politikën Italiane të kohës.

Ky gjest u konsiderua si krijimi i një sinteze të re, ku një pjesë e së djathtës u bashkua me të majtën, duke u ndarë sërish për të kjuar një “të djathtë të re”, ose të paktën mund të thuhet se këto kapërcime ishin pararendëse të zhvillimeve të mëvonshme.

Gjatë luftës së parë botërore, madje dhe para fillimit të luftës, Boshti përbrenda Italisë që mbështeste përfshirjen e kësaj të fundit në luftë dhe që kundërshtonte pacifistët e thekur dhe ato rryma internacionaliste që donin ta mbanin Italinë jashtë rrëmujës Europiane, humbi.

Idhtarë kyç të këtij boshti ishin Futuristët, D'Annunzianët dhe proto-fashistët në gji të Partisë Socialiste Italiane të cilët kombinonin kombëtarizmin me social-demokracinë italiane të asaj kohe.

D'Annunzio u martua dhe më duket se pati tre fëmijë, por në të njejtën kohë ishte ishte mjaft i njohur aventurat “dashurore” tepër të nxehta, të përbëra nga një zinxhir i gjatë dashnoresh. Ai dëfrehej me dy aktore Italiane jashtëzakonisht famëkeqe, mbi të cilat shkroi drama dhe opereta.

Konsiderohej si njëfarë bonvivanti, si një figurë rreth të cilit thuren mite. Deri sot e kësaj dite, D'Annunzio konsiderohet si një horr e kopuk i vetëkënaqur nga shumë rrethe, pasi kështu e paraqiste veten dhe egon mashkullore në veprat letrare.

Originaliteti i D'Annunzios është i vështirë për t'u matur. Filozofikisht, i detyrohej Niçes, artistikisht, i detyrohej traditës letrare Italiane që në thelb e ka origjinën tek Renesanca.

Përdorimi i shkëlqyer i stilit letrar i siguroi botimin e librave edhe sot e kësaj dite, por ai ende mbetet një nga figurat më të diskutueshme për shkak të pozicionit politik.

Vlen të diskutohet sa mirë do të zbatohet pa u vetëshkatërruar - për shkak të mungesës së praktikitetit - dëshira e tij për diktaturë të ngjyer në estetikë. Sidoqoftë, nuk mund të mohohet ajo gjallëri që D'Annunzio i ofroi politikës së hershme eksperimentale dhe së djathtës Italiane. D'Annunzio i dha licensën poetike atij autoritarizmi që e bëri fashizmin europiano-jugor jashtëzakonisht interesant përse i përket aspektit kulturor, paralel me regjimin Musolinian.

Dukuri interesante është rreshtimi i shumë intelektualëve me lëvizjen italiane së bashku me mnëyrën si bënë paqe me qeverinë e saj. Gjithashtu, përdorimi i një shtypjeje dorëlëshuar ishte pjesë përbërëse e kësaj doktrine të gjallërisë, të stilit dhe të kudondodhjes.

Në shumë tipare ishte një regjim shumë i vetëdijshëm për stilin, një ushtrim teatral. Shumë prej historianëve të pasluftës flasin për Italinë Fashiste sikur të ishte një lloj shoqërie teatrale me Musolinin në krye si pothuajse një aktor politik. Këto tipare u morën nga tradita D'Annunziane e mbrujtur në Fiume.

Fiume.

Qyteti i pushtuar nga D'Annunzio asokohe i përkiste Kroacisë, por banohej në shumicë nga italianë. Guvernatori Italian refuzoi të shtinte mbi D'Annunzion dhe paraushtarakët e tij. Pasi qyteti u vu nën kontrollin e paraushtarakëve, u krijua njëfarë shteti korporativ brenda qytetit. Fiume u shndërrua në qytet-shtet. D'Annunzianët se ky shtet i ri nuk do të merrte pjesë në Lidhjen e Kombeve, të cilën ata nuk e njihnin, pasi Italianët po shfrytëzoheshin nga detyrimet e Lidhjes së Kombeve, pararendëses së Kombeve të Bashkuara.

Ata krijuan njëfarë junte estetike fashiste që ishte pjesërisht teatër, pjesërisht hiper-realitet dhe pjesërisht administratë civile e mbështetur nga një krah i armatosur. Dalëngadalë, forcat e reaksionit, ashtu siç do ti kishte quajtur D'Annunzio, u përpoqën t'i kërkonin llogari Fiumes. Aleatët acaroheshin nga ekzistenca e saj e pavarur, nga statusi i qytet-shtetit. Nacionalistë italianë e njerëz të tjerë u dyndën për në Fiume, duke përfshirë këtu anarkistë dhe sindikalistë që admironin zellin e D'Annunzios dhe atë lloj kulti maçoist të aventurierizmit të çregullt Italian që buron nga traditat mesjetare.

Tradita të lashta italiane që admirohen jo pak. Sidoqoftë, shteti Italian u detyrua të veprojë. Predhat italiane ranë mbi Fiume, nga anijet luftarake që sapo kishin nisur të bombardonin qytetin. Pati një shpallje disi qesharake lufte kundër Italisë nga D'Annunzio, ku 3000 burra sfiduan një shtet kombëtar që mund të mbushte anije dhe aeroplanë me dhjetëra mijëra burra të gatshëm për luftë.

Sapo dëmi nga bombardimet u përkeqësua, ai ndërroi mendje duke u justifikuar se nuk mund të lejonte strukturën estetike të qytetit të dëmtohej, duke ia dorëzuar pushtetit të mëparshëm italian. Më vonë Fiume ra në dorë të Jugosllavëve pas ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare të nënshkruar posaçërisht për këtë punë.

Megjithatë, Fiume përfaqësonte një hyrje të drejtpërdrejtë të imagjinatës në jetën politike sepse deri diku D'Annunzio ndërthuri cilësi të artit interpretues në fjalorin e tij politik. Mund të thuhet me plot gojë që ai e konsideronte politikën si një formë teatri, në veçanti për masat.

Kjo sepse ishte elitist, pjesërisht i përçmonte masat, me përjashtim të rastit kur ato bëhen mjete të vullnetshme të vetëdijes kombëtare. Ai e teatralizoi politikën në mënyrë që t'i argëtonte masat pa i lejuar ato të kishin ndonjë ndikim tek domosdoshmëritë e rendit.

Kjo është ideja e politikës si art performativ ku masat luajnë rolin e audiencës që lejohet vetëm të reagojë por jo të udhëheqë, sepse tek D'Annunzio s'ka as edhe një grimë demokraci, dhe kjo provohet duke nisur që kulti vetanak i artistit e deri tek ajo pothuaj diktaturë e tij në Fiume. Ai përfaqësonte një sintezë mjaft të kullua ku dhuna e përdorur ishte kryesisht retorike, në masë të madhe e inskenuar, më tepër një lojë, dhe pjesërisht një lloj pjese teatrale.

Ekziston një ide post-moderniste sipas të cilës artistët mund të përplasnin makina, të djegin ndërtesa dhe më pas t'i shfaqin këto ngjarje në ekspozita të ndryshme pa kurrfarë pasoje. Është përpjekja për ta futur realitetin në hapësirën artistike.

D'Annunzio bëri të kundërtën.

Bëri një futje jo të realitetit në hapësirën artistike por të artistikes në hapësirën politike. Ai u hodh nga shkrimi i romaneve të shovinizmit, teprisë, grabitqarizmit mashkullor seksual e zellit Italian tek drejtimi i një qytet-shteti pothuajse pa ndeshur në ndonjë hendek të theksuar mes dy çasteve.

Në rrethanat e rrëmujshme të Italisë së pasluftës, ai gjeti një hapësirë në të cilën ëndrrat e tij, (kritikët do t'i quanin ëndrra bombastike) mund të realizoheshin. D'Annunzio ishte njëfarë ëndërrimtari me sy hapur por ai ishte gjithashtu kokëfortë dhe praktik dhe shumica e ushtrimeve të tij në politikën shoviniste u

realizuan ndryshe nga shumë ëndrra që përfundojnë në koshin e plehrave të alternativave politike.

Kështu, në njëfarë kuptimi, romani më i bukur i D'Annunzios ishte krijimi i atij që më vonë u quajt Shteti Fashist Italian, i cili deri në shkatërrimin e tij nga jashtë e brenda, ishte njëra nga shoqëritë më të qëndrueshme që kishte parë ndonjëherë Europa moderne.

Besimi tek aftësia e një kombi për t'u vetëripërtërirë përmes shkrirjes së prirjeve të ndryshme dhe sintetizimit tek vullneti i një burri largpamës është pjesë përbërëse e trashëgimisë së D'Annunzios. Për këtë arsye ai nuk mund të mjaftohej me artin, kjo është përnjëmend arsyeja pse reputacioni i tij është si me hije. Sepse artisti nuk mund të veçohet nga politikani dhe burrështetasi, cilësi që D'Annunzio i zotëronte me tërë mend.

Si do të ish zhvilluar bota nëse kombet Europiane do të ndikoheshin gjithmonë e më shumë nga këto figura artistike dhe sinkretike? Pothuajse të gjithë prijësat e së djathtës ekstreme, së bashku me disa të së majtës, kanë këto lloj tiparësh: individualitet të skajshëm, biografi shumëngjyrëshe, një lloj ndjesie anti-borgjeze, mohim të plotë të jetesës së rehatshme, besim në trajta të reja, dhe ndërtim i këtyre trajtave të modernitetit në mënyra pothuajse eksperimentale dhe kuturu.

Mundësia këtyre njerëzve u vjen vetëm gjatë luftës, rrënimëve ekonomike, rrëmujës dhe ndryshimit revolucionar kur gjithçka bëhet e gatshme për tu vënë nën kontroll dhe për t'u përhapur matanë kufijve.

Vihet re se periudha e pasluftës, me theks tek Europa perëndimore, mbizotërohet nga dy elementë. Së pari nga Lufta e Ftohtë, e cila e ngrin kontinentin në dy grupe kundërshtarë nën një sundim të pjesshëm amerikan të Bllokut Perëndimor dhe sundim të drejtpërdrejtë Sovietik, të bllokut Lindor.

Së dyti është frika e ndotjes kulturore si pasojë e ndryshimit, që mbështetet nga dëshira për të mbajtur në këmbë ekonomitë e tregut në një nivel të pranueshëm të mjaftueshmërisë. Hapësira

perëndimore liberale është qartësisht e frikësuar nga pasojat e një rrënimi ekonomik të mundshëm. Jo thjesht një ngadalësim, jo thjesht një depresion ose recesion ose grup recesionesh që përfundojnë në një depresion të stilit Japonez që mund të zgjasë për 20 vjet gjatë të cilëve nuk zhvillimi ndalet, por diçka shumë më shkatërrimtare. Një çarje dhe shembje sistematike e mirëfilltë.

Si mund të parashikohet se ç'demagogë apo ëndërrimtarë ngjisin shkallët e pushtetit kur njerëzit nxitojnë të votojnë sepse nuk paguajnë dot as takstat në kuptimin e plotë të fjalës? Kështu pra, D'Annunzio doli në pah në një periudhë të paqëndrueshëmrisë së vazhdueshme, duke i dhënë formën që ai dëshironte asaj paqëndrueshmërie, sepse Fiume ishte prototipi i një shteti.

Në Europën jugore të lashtësisë, qytet-shteti ishte pararendësi i shtetit kombëtar. Ai po përpiqej të ndërtonte një Athinë apo një Spartë, sipas imagjinatës, vullnetit e intelektit vetjak, që më vonë u realizua tek Italia Musoliniane në rang kombëtar. Nëse Italia do t'ia kishte dalë mbanë së gdhenduri një perandori në Afrikën e Veriut, kjo arritje do kish shërbyer si themel i një perandorie italiane sepse natyra e perandorive është gjithmonë zgjerimi.

Ky lloj pushteti perandorak gjithmonë acarohet nga mundësia e tkurrjes, e nëmos u përballtë me një fuqi tjetër më të madhe, gjithmonë do të skërmitet kundër kësaj tkurrije duke u përpjekur për ta shtyrë tutje me qëllim përfitim të sa më shumë vasalëve. Është e pashmangshme. Perandoria Britanike e ndodhur nën trysinë merkantiliste, ndoqi këtë drejtim për shumë shekuj derisa u stabilizua në shekullin e XX-të nëse mund ta quajmë kështu. Aty nga mesi i shekullit perandoria reshti së qeni.

Pra, ajo që do të shohim nëse do të ketë shembje të mëdha ekonomike në të ardhmen e afërt apo të largët është kthimi i llojit të politikës që D'Annunzio përfaqësonte. S'mund të parashikohet se ç'trajtë do të ketë, pasi gjërat nuk përsëriten.

Duken sikur përsëriten pasi sintezat që krijohen janë gjithmonë të reja dhe gjithmonë origjinale. Por ky kombinim i teatrit, letërsisë, demagogjisë vitale, shpirtit të sertë dhe luftarak të aventurierit vetmitar, shpirtit të grabitësit dhe rapsodit të armatosur, janë të gjitha tipare kyç të ideve që D'Annunzio përfaqësonte.

Fama e tij e keqe në Italinë e ditëve të sotme vjen për shkak të cilësive vetjake shumëgjyreshë dhe një pranie kryesisht kërcënuese, kërcënuese në kuptimin që Fashizmi Italian edhe pse shumë më tepër i integruar në narrativën historike, krahasuar me fashizmat e tjerë, është një hije fort djallëzore që mbulon popullin italian të pasluftës, mbi të cilin vetëdija nuk mungon. Sidoqoftë, vështirë të gjesh njerëz që guxojnë ta lavdërojnë atë sistem.

D'Annunzio besonte se guximi dhe besimi heroik tek ripërtëritja kombëtare ishin parimet e vetë jetës. Shembulli i tij, kaq i dallueshëm nga realiteti bashkëkohor, është interesant dhe fladitës.

D'Annunzio është njëfarë Jul Çezari i kryqëzuar me Jack London-in. Ekziston një shkrirje e çuditshme prirjesh tek një burrë i vetëm. Mahnitëse është mënyra sesi arriti ta kryejë këtë shkrirje plot stil e karizmë. Me gjasë ishte përvoja ushtarake që pati gjatë luftës së parë botërore që e lejoi të dilte nga shkrimorja letrare e të shkonte tek zyra e politikanit, tek ballkoni i shtetarit.

Dyshoj se do të kish pasur mjaftueshëm ndjekës po të mos përjetonte luftën drejt për së drejti. D'Annunzio përfaqëson këtë përzierje të çuditshme të aventurierit të pareshtur dhe poetit, të ëndërrimtarit dhe aktivistit, të stoikut dhe fanatikut.

Qytet-shteti i krijuar në Fiume siguronte tolerancë fetare dhe ateizëm, sepse niçeani D'Annunzio ishte ateist dhe nuk kishte ndonjë dell fetar, ndonëse paganizmi i letërsisë së tij buronte nga neo-paganët e Renesancës dhe nga Perandoria Romake.

Burimi i vërtetë i fuqisë morale të D'Annunzios duhet të ketë qenë Roma e lashtë. Shoqëria jonë moderne ka arritur të nxjerrë një numër të madh novelash që i kushtohen Romës së lashtë apo jo?

Përgjithësisht ndjekin rrymën e kohës. Historia Europiane na magjeps. Magjepssemi nga aspektet luftarake, aventuriere dhe autoritare të kësaj historie.

Me gjasë, Europa do të rigjallërohet nga fytyrime reflektive prej ndërmjetësuesish siç ishte dikur D'Annunzio. Do mbërrijë një Europë e aventurës, e aftësisë dhe e vullnetit Një Europë kokëkrisurish që kurrë nuk pranon "Jo" si përgjigje. Një Europë e burrit që i përsëriste pafund turmës, thirrjet e Akilit, dhe që dëgjonte *Guximtarët* që i përgjigjeshin me të njejtën monedhë.

Këto janë jehona të cilat ende mund të dëgjojen, dhe që nuk janë plotësisht të fjetura në Europën e sotme, siç u vërtetua nga luftrat e përgjakshme ballkanike të fundshekullit XX.

Gjigandët europianë të qëmotit po flenë, por gjumi i tyre shqetësohet nga dekadencia e ditëve të sotme. Establishmenti liberal bashkëkohor i frikësohet rikthimit të këtyre forcave dhe figurave. I frikësohet mbërritjes së vizionarëve, të udhëheqësve të rinj, të letrarëve dhe të burimeve të reja frymëzuese që kombinojnë vetjaken me kolektiven, kombin dhe qetësinë e shenjtë prej vetmitari.

Këto burime frymëzimi që kombinojnë Renesancën dhe Lashtësinë në një model të ri, i ofrojnë njeriut një shumësi të re detyrash dhe cilësish. Këtu ziejnë kuptimësitë e të qenit burrë, e të qenit europian, e të paturit një destin në botën moderne.

D'Annunzio farkëtoi një pjese të konsiderueshme të historisë Europiane të shekullit XX. Të paktën deri nga fundi i viteve 40. U lind aty nga mesi i shekullit të XIX-të, pra mund të themi me plot bindje se ky farkëtim ishte goxha arritje. Figurat e sotme po krijojnë atë sintezë që do t'i shërbejë fuqive që do të shfaqen gjatë gjysmëshekullit të ardhshëm.

